**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**Nr. 16/102**
**Datë: 26.10.2022**

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 tetor 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Shoqëritë Tregtare.

2. Obligohet Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

________________________________

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E INDUSTRISË, NDËRRMARRËSISË DHE TREGTISË
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PODUZETNIŠTVA I TRGOVINE/ MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE

# KONCEPT DOKUMENTI PËR SHOQËRITË TREGTARE

PRILL, 2022

## Përmbajtja

Përmbledhje e koncept dokumentit ........ 3
Hyrje ........ Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit ........ Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 2: Objektivat ........ Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 3: Opsionet ........ 22
Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim ........ 24
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit ........ 25
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë [përcaktohet veç e veç për secilin koncept dokument] ........ 25
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme ........ 26
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave ........ 27
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi ........ 28
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve ........ Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme ........ Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet ........ Error! Bookmark not defined.
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm ........ 31
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin ........ 31
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik ........ 32
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqëror ........ 35
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore ........ 40
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore ........ 43

## Përmbledhje e koncept dokumentit

| Informacionet e përgjithshme | |
|---|---|
| Titulli | Koncept Dokumenti për Shoqëritë Tregtare |
| Ministria bartëse | Ministria e Industrisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë |
| Personi kontaktues | Mehdi Pllashniku, Zv. Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, Ministria e Indu<br><br>strisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë ARKB/ MINT |
| Programi Qeveritar 2021 - 2025 | Ndërlidhet me Përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes, për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe zhvillimit të konkurrueshmërisë, do të avancojmë kornizën ligjore për konkurrencën, shoqëritë tregtare dhe përmirësimin e regjistrave të bizneseve për të mundësuar një administrim efikas të tatimeve, menaxhim efektiv të pajtueshmërisë dhe ofrimin e statistikave të duhura. kodin për qeverisje të korporatave. |
| Prioriteti strategjik | Përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe zhvillimi të konkurrueshmërisë në sektorin privat,<br>Objektivi Operacional: 1.3 Përmirësimi i kornizës ligjore të shoqërive tregtare,<br>1.3.1 Miratimi i Hartimi i Koncept Dokumentit për shoqëritë tregtare. |

| **Vendimi** | |
|---|---|
| Çështja kryesore | Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë dhe shoqëritë tregtare gjatë implementimit të Ligjit për shoqëritë tregtare kanë hasur në vështirësi në përmbushjen e dispozitave ligjore, pamundësia e zbatimit të kërkesave ligjore nga korporatat per kuoten gjinore, nevoja për harmonizim te mëtejme me legjislacionin e BE-se, mungesa e një sistemi te integruar te ARBK-se me ATK-se, mungesa e dispozitave ndëshkuese për mos zbatim te ligjit, nevoja për avancim te mëtejme te shërbimeve elektronike sa i përket regjistrimit, ndryshimeve, çregjistrimit, shuarjes se bizneseve. |
| Përmbledhje e konsultimeve | |
| Opsioni i propozuar | Plotësim ndryshim i Ligjit për Shoqëritë Tregtare |

| **Ndikimet kryesore të pritshme** | |
|---|---|
| Ndikimet buxhetore | [Shënoni ndikimin në buxhet. Nëse opsioni i propozuar mbulohet nga kufiri aktual i buxhetit atëherë shënoni 'zbatohet në kuadër të kufijve aktual buxhetor'.] |
| Ndikimet ekonomike | [Shënoni ndikimet më të rëndësishme në këtë kategori. Nëse nuk ka ndikime relevante, shënoni 'nuk ka ndikime relevante të pritshme në këtë kategori'.] |
| Ndikimet shoqërore | Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta në këtë kategori |

| | |
|---|---|
| Ndikimet mjedisore | Nuk ka ndikime të drejtpërdrejta në këtë kategori |
| Ndikimet ndër-sektoriale | Institucione juridike, administrative shtetërore, publiko - privat, OJQ, biznese publike dhe private |
| Ngarkesat administrative për kompanitë | Nuk ka ndikime |
| Testi i NVM-ve | Largimi i kuotës gjinore 50% te grave ne borde ndikon pozitivisht te NVM-korporatat.<br>2.Me rastin e themelimit te SHPK-ve te përcaktohet kapitali themeltar. |

| **Hapat e ardhshëm** | |
|---|---|
| Afatshkurtër | Plotësim ndryshimi i Ligjit për Shoqëritë Tregtare |
| Afatmesëm | Hartimi i akteve nënligjore për zbatim të Ligjit për Shoqëritë Tregtare |

# HYRJE

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përkatësisht Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) është përgjegjëse për hartimin e kornizës ligjore në fushën e shoqërive tregtare, duke u bazuar në prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës përkatësisht në programin e Qeverisë dhe dokumenteve strategjike.

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë vepron në kuadër të Ministrisë Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që është institucion i vetëm përgjegjës për regjistrimin e bizneseve të Kosovës. ARBK funksionon në bazë të një sistemi elektronik të dhënash si një proces më i thjeshtë, më i shpejtë, pa shpenzime për regjistrimin e bizneseve fillestare që realizohet përmes lidhjes ndërmjet 29 qendrave komunale të regjistrimit (me mundësi të shtimit të tyre) të njohura si zgjidhje "one-stop-shop" me zyrën qendrore të ARBK-së. Sistemi i tanishëm ka ndikuar në rritjen e transparencës, si dhe ka një rritje të standardeve dhe përpjekjeve për të harmonizuar procedurat e regjistrimit me direktivat e Bashkimit Europian. ARBK është institucion i orientuar drejtë zhvillimit që ofron arritjen e efikasitetit më të madhe, me një cilësi të lartë për të gjithë operatorët ekonomik që operojn në Kosovë. Ku si fokus ka krijimin e një imazhi ndihmës për procedurat administrative të regjistrimit në ndihmë të biznesit dhe përmirësimit të ambientit të biznesit në vend përderisa, për qëllim ka të ofrojë një shërbim institucional të përgjegjshëm dhe të krijojnë një kulturë administrative tek biznesi.

Me vendimin e datës 12.08.2021 me numër të protokollit 5817, zëvendësuesi i sekretarit në MINT, me propozim të ARBK-së ka formuar grupin punues për hartimin e Koncept Dokumentit për fushën e shoqërive tregtare.

Ky Koncept Dokument është përfshirë edhe në listën e Koncept Dokumenteve për vitin 2021.

Qëllimi i këtij Koncept Dokumenti është që të propozoj opsionin më adekuat për të adresuar problemin kryesor të identifikuar nga grupi punues, problem ky i cili krijon vështirësi në funksionimin dhe regjistrimin më të mirë të shoqërive tregtare.

Bazuar në Udhëzuesin dhe Doracakun për Hartimin e Koncept Dokumenteve është hartuar ky Koncept Dokument i cili do të propozoj opsionin e rekomanduar nga grupi punues.

*Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin*

| | |
|---|---|
| Titulli | Koncept Dokumenti për Shoqëritë Tregtare |
| Ministria bartëse | Ministria e Industrisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë |
| Personi kontaktues | Mehdi Pllashniku, Zv. Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë ARKB/ MINT |
| Programi Qeveritar 2021 - 2025 | Ndërlidhet me Përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes, për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe zhvillimit të konkurrueshmërisë, do të avancojmë kornizën ligjore për konkurrencën, shoqëritë tregtare dhe përmirësimin e regjistrave të bizneseve për të mundësuar një administrim efikas të tatimeve, menaxhim efektiv të pajtueshmërisë dhe ofrimin e statistikave të duhura. kodin për qeverisje të korporatave. |

| | |
|---|---|
| | |
| Prioriteti strategjik | Ndërlidhet me Qëllimin Strategjik saktësisht me Përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe zhvillimi të konkurrueshmërisë në sektorin privat,<br>Objektivi Operacional: 1.3 Përmirësimi i kornizës ligjore të shoqërive tregtare,<br>1.3.1 Hartimi i Koncept Dokumentit për shoqëritë tregtare. |
| Grupi punues | 1. Mehdi Pllashniku, Zv. Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë ARKB/ MINT (Kryesues)<br>2. Dardan Nallbani, Ministria e Industrisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë / MINT (anëtar)<br>3. Mensur Azemi, Ministria e Industrisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë / MINT(anëtar)<br>4. Merlinda Ramaj, Ministria e Industrisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë / MINT (anëtare)<br>5. Bujar Pefqeli, Dogana e Kosovës / DK (anëtar)<br>6. Albana Krasniqi, Zyra Ligjore e Kryeministrit / ZKM (anëtare)<br>7. Ilir Islami, Administrata Tatimore e Kosovës / ATK (anëtar)<br>8. Shkurte Krasniqi, SKQ/ZKM (anëtare)<br>9. Zana Radoniqi, Ministria e Financave/MFPT (anëtare)<br>10. Gani Seferi, Ministria e Industrisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë / MINT (anëtar)<br>11. Driton Bublaku, Ministria e Industrisë, Ndërrmarrësisë dhe Tregtisë / MINT (anëtar) |

**Kapitulli 1:**

## Përkufizimi i problemit

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë dhe shoqëritë tregtare gjatë implementimit të Ligjit Nr. 06/1-016 për Shoqëritë Tregtare kanë hasur në vështirësi në përmbushjen e dispozitave ligjore si dhe janë identifikuar disa çështje për të cilat është e nevojshme të plotësohet legjislacioni aktual:

1) *Mosharmonizimi i dispozitave ligjore*
2) *Kërkesa ligjore për 50% të grave në bord të drejtorëve të korporatave*
3) *Mungesa e kapitalit themeltare për SH.P.K;*
4) *Pamundësia e plotësimit të statutit me ndryshime;*
5) *Mungesa e rregullimit ligjor që ARBK të mbaj një listë të bizneseve jo aktive;*
6) *Publikimi i raporteve financiare të KKRF në ueb faqen e ARBK-së.*
7) *Mospërputhja e dispozitave ligjore te Ligjit Nr. 06/l -016 për Shoqëritë Tregtare me Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore lidhur me regjistrimin e përfaqësuesit fiskal.*

8) *Aktualisht, sipas Ligjit Nr. 06/l -016 për Shoqëritë Tregtare me rastin e vdekjes së pronarit të Biznesit Individual nuk lejohet pronësia e biznesit të kalojë tek trashëgimtari dhe humb historia e biznesit.*

### *1.1 Korniza e politikave dhe e legjislacionit të Kosovës*

Në Republikën e Kosovës ekziston një nivel i normimit lidhur me shoqëritë tregtare si dhe çështje tjera të ndërlidhura. Kjo kornizë ligjore, e cila është objekt elaborimi edhe në tabelën e mëposhtme, përbëhet nga aktet ligjore dhe nënligjore si në vijim:

Ligji Nr. 06/1 -016 për Shoqëritë Tregtare si dhe aktet nënligjore si në vijim:

1. Udhëzim administrativ (MTI) nr. 11/2018 për përcaktimin e taksave për shërbimet e ofruara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve;
2. Udhëzim administrativ (QRK) nr.01/2019 për caktimin e kërkesave, kushteve dhe procedurave për krijimin e numrit unik identifikues;
3. Udhëzim administrativ (MTI) nr. 01/2020 për ruajtjen dhe shfrytëzimin e materialit arkivor në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve;
4. Udhëzimi administrativ (MTI) nr. 02/2020 për procedurën e regjistrimit të emrit zyrtar dhe emrit tregtar të shoqërive tregtare;
5. Udhëzim administrativ (MTI) nr. 14/2020 për çregjistrimin e bizneseve në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve;
6. Udhëzim administrativ (QRK) - nr. 05/2021 për regjistrimin e zyrave së përfaqësisë të shoqërive të huaja tregtare;
7. Udhëzim administrativ (MINT) nr. 01/2021 për regjistrimin e shoqërive tregtare.
8. Kodi i Qeverisjes Korporatave, Miratuar nga Ministrja e MINT, me datë 03.06.2021.

**Ndërsa, aktet ligjore potencialisht të ndërlidhura me shoqëritë tregtare janë:**

1. Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat;
2. Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike
3. Ligji Nr.2003/9 për Kooperativat e Bujqve.
4. Ligji Nr.06/L-022 për Ndërmarrjet Sociale;
5. Ligji Nr.05/L-083 për Falimentim.

Tabela në vijim paraqet ***Kornizën e politikave dhe e legjislacionit të Kosovës*** *mbi bazën te të cilave është zhvilluar analiza e këtij koncept dokumenti*

| **Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor** | **Lidhja me Gazetën Zyrtare** | **Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim** | **Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)** |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ligji Nr. 06/L-016 Për Shoqëri Tregtare; | https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12540 | Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës | **Zbatimi i legjislacionit:** Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës funksionon si organ qendror i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për regjistrimin e shoqërive tregtare dhe bën regjistrimin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë, si dhe është e autorizuar për kryerjen e funksioneve të tjera të përcaktuara me këtë Ligj apo funksioneve që i janë caktuar ARBK me ligje të tjera.<br>Ky ligj zbatohet për të gjitha shoqëritë tregtare dhe subjektet tjera të përcaktuara në këtë ligj. Rregullat për lëshimin e lejeve, licencave ose formave të tjera të lejimit, rregullimi i aktiviteteve në të cilat angazhohet shoqëria tregtare pas regjistrimit, kontabiliteti, raportimi financiar, tatimet si dhe praktikat e punës dhe punësimit të shoqërive tregtare nuk janë në fushëveprim të këtij ligji – përveç shkëmbimit të të dhënave ndërmjet sistemeve elektronike të institucioneve përgjegjëse për këto fusha në ARBK, duke përfshirë institucionet përgjegjëse për administratën tatimore dhe raportimin financiar. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat (i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe 04/L-223. | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2689 | Administrata Tatimore e Kosovës | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** ATK është përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, Ligjin mbi Tatimin në të Ardhurat Personale, Ligjin mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Ligjin mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar dhe çdo legjislacioni tjetër të zbatueshëm në Kosovë e që i ngarkon detyrën të administrojë çdo lloj tatimi. Aktualisht tatimet në përgjithësi në Kosovë rregullohen me ligje të veçanta, varësisht llojit të tatimit (Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - TVSh, me Ligjin Nr. 05/L-037, Tatimi në të Ardhura Personale - TAP, me Ligjin Nr. 05/L-028, si dhe Tatimi në të Ardhurat e Korporatave - TAK, me Ligjin Nr.06/L-105), kurse procedurat i rregullon Ligji Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-102 dhe 04/l-223. |
| Ligji për Koperativat e Bujqëve (i plotësuar dhe ndryshuar) | https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2472 | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural? | **Hartimi i legjislacionit dhe mbikëqyrja e zbatimit**<br><br>**Zbatimi i legjislacionit:** Ligji Nr.2003/9 për Kooperativat e Bujqëve është miratuar me datë 15 Maj 2003 nga Kuvendi i Kosovës. Me datë 23 Qershor 2003 është nxjerr UNMIK/RREG/2003/21 për Shpalljen e Ligjit të Miratuar nga Kuvendi i Kosovës mbi Kooperativat Bujqësore. Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 14 Maj 2004 ka nxjerr Udhëzimin Administrativ Nr.06/2004 për |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | Përmbajtjen e Statutit dhe Kushtet e Regjistrimit të Kooperativave të Bujqëve. Ligji Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare Neni 5 paragrafi 3 - Me ligj të veçantë mund të përcaktohen edhe forma të tjera të organizimit të Shoqërive Tregtare ose subjekte tjera që kërkohet të regjistrohen në ARBK. Kooperativa e Bujqëve sipas Ligjit Nr.2003/9 për Kooperativat e Bujqëve, Neni 6 - Është person juridik. Kooperativa e Bujqëve nënkupton një entitet ligjor të krijuar nga personat fizikë dhe juridik. Në ARBK që nga viti 2003 e deri me sot janë regjistruar 146 Kooperativa Bujqësore. Me datë 03 Tetor 2008 është miratuar Ligji Nr.03/L-004 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kooperativat e Bujqëve Nr.2003/9. |
| **Programi Qeveritar** | | Qeveria e Republikës se Kosovës | Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës si qëllim strategjik ka përcaktuar Përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes. Për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe zhvillimit të konkurrueshmërisë, do të avancojmë kornizën ligjore për konkurrencën, shoqëritë tregtare dhe përmirësimin e regjistrave të bizneseve për të mundësuar një administrim efikas të tatimeve, menaxhim efektiv të pajtueshmërisë dhe ofrimin e statistikave të duhura. |
| **Raporti i Progresit për Kosoven fq. 76** | | | Raporti i Progresit ka theksuar se nevojitet një harmonizim i mëtejmë me acquis e të drejtës së kompanive të BE-së, veçanërisht në lidhje me kërkesat minimale të kapitalit, të drejtat e aksionarëve, blerjet e kompanive, disa aspekte të bashkimeve ndërkufitare dhe kërkesat e zbulimit informative të degëve të huaja dhe Direktivave te BE- |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | së 2019 për përdorimin e mjeteve digjitale. Koordinimi i pamjaftueshëm dhe ndarja e të dhënave në mes të ARBK-së dhe Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KCFR), çon në një situatë ku raportimi dhe publikimi në kohë i dokumenteve të kontabilitetit është i kufizuar. Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) nuk publikon informacione mbi kompanitë në disa situata ligjore (p.sh. nën procedurat e falimentimit). Nuk ka asnjë detyrim ligjor për publikimin e dokumenteve të kontabilitetit në regjistrin e biznesit. |
| **PSO 2022 2025 SKZH** | | Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë | Plani Strategji Operacional 2022 – 2025 si qëllim strategjik ka përcaktuar Përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe zhvillimi i konkurrueshmerise në sektorin privat ku parashihet edhe Përmirësimi i kornizës ligjore të shoqërive tregtare, Miratimi i Hartimi i Koncept Dokumentit për Shoqëritë Tregtare si dhe i Ligjit për Shoqëritë Tregtare. |
| **Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2022 - 2024** | | Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë | Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2022 – 2024, 3.6. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive; parasheh miratimin e Koncept-dokumentit për plotësim ndryshimin e Ligjit për Shoqëritë Tregtare |
| **Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) II** | | Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë | Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) II gjithashtu tek II. Konkurrueshmëria, klima e investimeve dhe zhvillimi i qëndrueshëm ka paraparë përmirësimin e mjedisit afarist dhe me të miratimin e Koncept dokumentit për ligjin për shoqëritë tregtare. |

## Përafrimi me të drejtën e BE-së

Në fushën e së drejtës së kompanive ekzistojnë një numër i Direktivave të BE-së të cilat shtetet anëtarë të BE-së kanë bërë harmonizimin e legjislacionit të tyre në këtë fushë.

Në lidhje me aplikimin e legjislacionit të fushës së drejtës së kompanive, Republika e Kosovës ka marre obligime me Marrëveshjen për Stabilizim Asocimin që të bëjë harmonizimin e legjislacionit me atë të BE-së.

Tabela: Instrumentet ligjore të BE-së apo direktivat e me të cilat Ligji për Shoqëritë tregtare është i përafruar

| Direktiva e BE-së | Përshkrimi | Përputhshmëria me Ligjin për Shoqëritë Tregtare |
|---|---|---|
| **Direktiva 2009/101/EC** | Direktiva e datës 16 shtator 2009 për bashkërendimin e masave mbrojtëse të cilat kërkohen, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe palëve të treta, nga shtetet anëtare të kompanive në kuadër të kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 48 të Traktatit, me pikëpamjen që këto masa mbrojtëse të bëhen të barasvlershme; | Pjesërisht |
| **Direktiva 89/666/EEC** | Direktiva e datës 21 dhjetor 1989 mbi kërkesat për zbulim sa i përket degëve të hapura në një Shtet Anëtar nga lloje të caktuara kompanish të rregulluara me ligj të një Shteti tjetër | Pjesërisht |
| **Direktiva 2011/35 / EU** | Direktiva e datës 5 prill të vitit 2011 mbi bashkimet e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar; | Pjesërisht |
| **Direktiva 82/891/EEC** | Direktiva e datës 17 dhjetor 1982, bazuar në nenin 54 (3) (g) të Traktatit, mbi ndarjet e shoqërive tregtare publike me përgjegjësi të kufizuar, këtu e tutje direktiva 82/891/EEC; | Pjesërisht |
| **Direktiva 2005/56/EC** | Direktiva e datës 26 tetor 2005 për bashkimet ndërkufitare të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar; | Pjesërisht |
| **Direktiva 2012/17/EU** | Direktiva e datës 13 qershor 2012, sa i përket ndërlidhjes së regjistrave qendror, komercial dhe të shoqërive tregtare. | Pjesërisht |
| **Direktiva 2012/30/EU** | Direktiva e datës 25 tetor 2012, për bashkërendimin e masave mbrojtëse të cilat kërkohen, për mbrojtjen e interesave të anëtarëve dhe të tjerëve, nga Shtetet | Pjesërisht |

| | | |
|---|---|---|
| | Anëtare të kompanive në kuadër të kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 54 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, sa i përket formimit të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe mirëmbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre, me pikëpamjen që këto masa mbrojtëse<br>të bëhen të barasvlershme; | |

**Problemi kryesor, shkaqet dhe efektet**

*Figura 2: Pema e problemit që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet*

| | |
|---|---|
| **Efektet:** | 1. Vështirësitë në regjistrimin të korporatave;<br>2. Largimi i investitorëve nga vendi;<br>3. Pamundësia në masën e duhur të shërbimeve elektronike. |
| | |
| **Problemi kryesor:** | Vështirësitë në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr. 06/1 -016 për Shoqëritë Tregtare si dhe nevoje e krijimit të dispozitava te reja |
| **Shkaqet:** | 1. Mosharmonizimi i dispozitave ligjore te Ligjit per Shoqëritë Tregtare<br>2. Kuota gjinore – pamundësia e zbatimit të kërkesave ligjore nga korporatat;<br>3. Ligji aktual nuk ka përcaktuar kapital themeltare për SH.P.K.;<br>4. Nevoja për harmonizim te mëtejme me legjislacionin e BE-se;<br>5. Mungesa e një sistemi te integruar te ARBK-se me ATK-se si dhe mosharmonizimi i legjislacionit përkatës;<br>6. Nevoja për avancim te mëtejme te shërbimeve elektronike sa i përket regjistrimit, ndryshimeve, çregjistrimit, shuarjes se bizneseve;<br>7. Pamundësia e bartjes se pronësisë se biznesit tek trashëgimtari. |

## Analiza e problemeve dhe shkaqeve

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës, gjatë viteve 2000 - 2021 ka regjistruar 211758 biznese ndërsa gjatë kësaj periudhe kohore janë shuar 30435 biznese.

**Vështirësitë në zbatim të dispozitave të Ligji Nr. 06/l -016 për Shoqëritë Tregtare**

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare janë paraqitur vështirësi në implementim si në vijim:

1) **Mosharmonizimi i dispozitave ligjore** (Ne Neni 33 dhe 34 te Ligjit per Shoqerite tregtare ne statutin e SHoqerite Tregtare nuk eshte i perfshire përfaqësuesi i autorizuar ose Bord

të Drejtorëve (nëse ka tek SHPK). Ndërsa, sipas Neni 164 paragrafi 2 eshte parapare qe bordi i drejtoreve te përfshihet ne statut.

Neni 24 Paragrafi 5 - Për të regjistruar një Përfaqësues të Autorizuar në ARBK, Shoqëria Tregtare duhet të dorëzojë në ARBK aplikimin për regjistrim. Vendimi i organit kompetent për të emëruar Përfaqësuesin e Autorizuar i bashkëngjitet aplikimit për regjistrim. Për të regjistruar Përfaqësuesin e Autorizuar, kërkohet pëlqimi i tij apo saj me shkrim. Organi kompetent i Shoqërisë Tregtare për emërimin e Përfaqësuesit të Autorizuar mundet që në çdo kohë, pa marrë parasysh arsyen, të ndërpresë autorizimet e Përfaqësuesit të Autorizuar si dhe të bëjë ndryshimet përkatëse në Regjistër. Në rast të dorëheqjes nga Personi i Autorizuar nga kjo pozitë, Personi i Autorizuar mund të kërkojë nga ARBK për të bërë ndryshimet përkatëse në Regjister, nëse dorëzon në ARBK dokumentin e dorëheqjes dhe dëshminë që ka njoftuar organin kompetent të Shoqërisë Tregtare për dorëheqjen.

Ky nen është në kundërshtim me Nenin 108 paragrafi 1 Aksionarët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, ose Bordi i Drejtorëve, do të përcaktojnë personin ose personat e caktuar për të shërbyer si drejtorë menaxhues. Personi/at në fjalë kanë kompetencat e përcaktuara në nenin 109 të këtij ligji. Kur ka më shumë se një drejtor menaxhues, Aksionarët ose Bordi i Drejtorëve mund të përcaktojnë tituj, detyra dhe autorizime të ndryshme për secilin prej tyre. Drejtori menaxhues mund të caktohet, largohet ose zëvendësohet vetëm në bazë të votës së Aksionarëve ose të Bordit të Drejtorëve.)

Dihet botërisht se Statuti i një Korporate është Kushtetutë, prandaj anëtarët e emëruar në BD duhet të ceken me emër dhe mbiemër, po ashtu edhe Përfaqësuesi i Autorizuar duhet të jetë në statut me emër dhe mbiemër.

2) **Kërkesa ligjore për 50% të grave në bord të drejtorëve të korporatave** (Ne Nenin 34, Regjistrimi Fillestar i një Shoqërie Aksionare tek paragrafi 2.5. numri i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe Drejtorëve Menaxhues të Shoqërisë Aksionare:

   2.5.1 numri i anëtarëve të Bordit të drejtorëve të shoqërisë aksionare duhet të përmbajë edhe kuoten prej dyzet përqind (40%) pjesëmarrje të grave në Bord;

   2.5.2 zbatimi i kësaj kuote duhet të filloj jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas miratimit të Ligjit;

   2.5.3. pas dy (2) viteve të zbatimit të ligjit, kuota gjinore fillon aplikimin e saj në 50%.

   Neni 34, Regjistrimi Fillestar i një Shoqërie Aksionare, paragrafi 2.5. Bazuar në nenin 107, paragrafi 2 SH.P.K. mund të krijojë një bord të drejtorëve nëse kjo është e rregulluar me statutin e SHPK. Nëse SHPK krijon bordin e drejtorëve, autorizimet e tij, numrin e anëtarëve, mënyrën e zgjedhjes, kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë si dhe mënyrën e votimit në bord do ta përcaktojë statuti i SHPK. Dispozitat në lidhje me bordin e drejtorëve të SH.A. aplikohen respektivisht. Qeveria norvegjeze ishte e para e cila ka vendosur kuotën për femra prej 40% në 2003 si për firmat shtetërore ashtu edhe për kompanitë e tregtuara publike.

   Në vitin 2007, Spanja miratoi një kuotë të butë për femra prej 40%, e cila nuk zbatohet plotësisht. Kjo zbatohet vetëm për kompanitë e tregtuara publikisht me mbi 250 punonjës. Për shembull, në Spanjë çdo emërim i bordit i cili shkel kuotën konsiderohet i pavlefshëm. Në Norvegji, pasojat janë më të rënda: Kompanitë që nuk respektojnë kuotat gjinore shpërbëhen dhe selitë e tyre detyrohen të zhvendosen në një vend tjetër.

Vendet e tjera me legjislacion për kuota janë: Belgjika (33%), Hollanda (30%), Gjermania (30%), Franca(40), Islanda (40%), Italia (33%) dhe Finlanda (se paku një grua).
Të dhënat janë nga artikulli (https://dobetter.esade.edu/en/women-gender-balance) i bazuar në hulumtimin e publikuar në Gazeta e Etikës së Biznesit (Journal of Business Ethics).

3) **Mungesa e kapitalit themeltare për SH.P.K;** (Neni 33 - Regjistrimi Fillestar i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, nuk parasheh kapital fillestar.)
4) **Pamundësia e plotësimit të statutit me ndryshime;** (Neni 40 paragrafi 3.3 nëse Statuti ndryshohet, tekstin e plotë të Statutit të ndryshuar.
Neni 41 paragrafi 3.3 nëse Statuti ndryshohet, tekstin e plotë të Statutit të ndryshuar.
Neni 41 paragrafi 3.4. nëse emërohen Drejtorë të rinjë Menaxhues apo anëtarë të rinjë të Bordit të Drejtorëve apo emërohet Përfaqësuesi i ri i Autorizuar, emrat dhe adresat e personave të emëruar dhe informata nëse ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar vetëm apo duhet të veprojnë bashkërisht;
5) **Mungesa e rregullimit ligjor që ARBK të mbaj një listë të bizneseve jo aktive;**
Mungesa e nje liste te bizneseve jo aktive ne vazhdimësi eshte duke shkaktuar problem ne identifikimit e bizneseve aktive dhe jo aktive. Njekosisht ka mos harmonizim te dhënave rreth bizneseve aktive ne mes te ARBK dhe ATK.
Pas nenit 46, të ligjit për Shoqëritë Tregtare duhet të futen një ose më shumë nene të reja për të rregulluar sa vijon:

a. transferimi i detyruar i biznesit në statusin pasiv (përfshirë përcaktimin e kushteve dhe procedurës për kalimin e biznesit në statusin pasiv)
b. njoftimi i biznesit përpara një lëvizjeje të tillë, duke përfshirë dhënien e afateve kohore për ti mundësuar që të lajmërohet dhe të bëjë ndryshimet e kërkuara nëse është e nevojshm)
c. të përfshihen norma që mundësojnë Kalimi vullnetar i biznesit në status pasiv (në bazë të kërkesës së pronarit);
d. kushtet dhe procedura se si një biznes pasiv mund të kthehet në gjendje aktive;
e. neni aktual 47 i ligjit duhet të zgjerohet për trajtimin e ankesave për kalim të detyruar dhe vullnetar në status pasiv;

Këto ndryshime duhet të reflektohen edhe në legjislacionin sekondar: Udhëzimi Administrativ (MTI) Nr. 03/2020 për mënyrën dhe procedurën e regjistrimit dhe ndryshimit të të dhënave të shoqërive tregtare në Agjencinë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve. https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=29839
Në UA nr. 03/2020, pas nenit aktual 14, duhet të rregullohet në detaje procedura për kalimin e bizneseve në listën pasive, duke përfshirë kthimin e mundshëm në listën aktive të bizneseve kur të plotësohen kushtet e Ligjit.
6) **Publikimi i raporteve financiare të KKRF në ueb faqen e ARBK-së.**

Me Ligjin Nr. 06/L-032 per kontabilitet, Rapotim Financiar dhe Auditim obligohen bizneset qe nje kopje te raportit financiar te dorëzohet ne MINT/ARBK. Me Ligjin

Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare nuk ka dispozite ligjore qe i obligon ARBK te publikon raportet financiare te bizneseve.

7) **Mosperputhja e dispozitave ligjore te Ligjit Nr. 06/l -016 për Shoqëritë Tregtare me Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore lidhur me regjistrimin e përfaqësuesit fiskal.**
Gjatë implementimit të ligjit për shoqëritë tregtare është par e nevojshme haramonizimi i Ligji Nr. 06/l -016 për Shoqëritë Tregtare me Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, përkatësisht dispozita aktuale që lidhet me Veprimtarinë Ekonomike në Kosovë e cila sipas ligjit aktual mund të ushtrohet vetëm nga Shoqëritë Tregtare të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe me ligj. Kjo dispozitë, ashtu siç është interpretuar nga ARBK ka paraqitur vështirësi në zbatim nga ATK, ku ne ATK regjistrohen edhe persona tjerë të cilët nuk kërkohen të regjistrohen në ARBK por, që duhet të pajisen me Numër Fiskal nga ATK për pagesën e ndonjë lloj tatimi. Si, p.sh. rasti i regjistrimit të Përfaqësuesit Fiskal në ATK nga i cili kërkohet të regjistrohet dhe të kryejë detyrimet tatimore në emër të kompanisë së jashtme e cila nuk plotëson kriteret për regjistrim në Kosovë, gjegjësisht në ARBK pasi që nuk krijon Njësi të Përhershme, por që brenda disa ditëve apo orëve kryen një shërbim në Kosovë. Në këtë rast po themi qe Vendi i Furnizimit të shërbimit është Kosova dhe shërbimi i tille i është ofruar një personi në Kosovë që nuk është Deklarues për TVSH dhe në këtë rast kërkohet angazhimi i Përfaqësuesit Fiskal. ATK i Regjistron Përfaqësuesit Fiskal në Kosovë, ju lëshon Numrin Fiskal, ju hap llogarinë tatimore përkatëse (p.sh. TVSH, Tatim ne paga, Qira, etj.) dhe nga ata kërkon pagesën e tatimit. Bankat Komerciale nuk i hapin llogarinë bankare Përfaqësuesit Fiskal pasi që sipas tyre ARBK dhe FIC kanë një komunikim që llogaria bankare mund të hapet vetëm në emër të biznesit kështu që këtë person sipas tyre e detyrojnë me hap biznes nëse dëshiron me hap llogarinë bankare, ndërsa sipas ATK ky person patjetër duhet me pas llogarinë bankare në Kosove në emër të Përfaqësuesit Fiskal dhe ti paguaj detyrimet tatimore. Ne kemi diskutuar me ARBK, që kjo dispozitë ligjore, citojmë: "Veprimtaria Ekonomike në Kosovë mund të ushtrohet vetëm nga Shoqëritë Tregtare të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, përveç nëse është përcaktuar shprehimisht ndryshe me ligj", fjalia pas presjes le te nënkupton qe nëse me një Ligj tjetër p.sh. Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat parasheh regjistrimin e Përfaqësuesit Fiskal, kjo nuk duhet të jetë pengesë për hapje të llogarisë bankare në emër të Përfaqësuesit Fiskal.

8) **Sipas Ligjit Nr. 06/l -016 për Shoqëritë Tregtare është se me rastin e vdekjes së pronarit të Biznesit Individual nuk lejohet pronësia e biznesit të kalojë tek trashëgimtari dhe humb historia e biznesit.**
Po ashtu, sipas Udhëzimit Administrativ NR.03/2020 për mënyrën dhe procedurën e regjistrimit dhe ndryshimit të dhënave të shoqërive tregtare në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, gjegjësisht Nenit 5, paragrafit 3 nuk lejohet ndërrimi i pronësisë.

## Harmonizimi me Direktivat e BE-se

Në fushën e së drejtës së kompanive ekzistojnë një numër i Direktivave të BE-së të cilat shtetet anëtarë të BE-së kanë bërë harmonizimin e legjislacionit të tyre në këtë fushë.

Në lidhje me aplikimin e legjislacionit të fushës së drejtës së kompanive, Republika e Kosovës ka marre obligime me Marrëveshjen për Stabilizim Asocimin që të bëjë harmonizimin e legjislacionit me atë të BE-së.

Ne vijim janë instrumentet ligjore apo direktivat të cilat janë rekomanduar nga BE-së qe te transpozohen ne Ligjin për Shoqëritë Tregtare:

**Direktiva (BE) 2017/1132** – kodifikimi i disa aspekteve të ligjit për shoqëritë tregtare në lidhje me shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar. Direktiva kodifikon një sërë direktivash të mëparshme mbi disa aspekte të së drejtës evropiane për shoqëritë tregtare. Këto direktiva kishin të bënin me fusha kyçe të së drejtës evropiane të shoqërive tregtare, të tilla si:
- shpalosja e informacionit për kompanitë në regjistrat e biznesit;
- mbajtja e kapitalit;
- ndarjet e kompanive;
- bashkimet brenda një vendi; si dhe
- bashkimet ndërkufitare.

Direktiva kodifikon dhe zëvendëson gjashtë direktivat e mëposhtme:
- Direktiva 82/891/KEE lidhur me ndarjen e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar;
- Direktiva 89/666/KEE në lidhje me kërkesat e shpalosjes për degët e hapura në një vend të BE-së nga lloje të caktuara shoqërish të rregulluara nga ligji i një vendi tjetër;
- Direktiva 2005/56/KE për bashkimet ndërkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar;
- Direktiva 2009/101/KE për koordinimin e masave mbrojtëse që kërkohen nga vendet e BE-së prej kompanive në kuptimin e paragrafit të dytë të nenit 48 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, me synimin për t'i bërë këto masa mbrojtëse ekuivalente;
- Direktiva 2011/35/BE lidhur me bashkimet e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar;
- Direktiva 2012/30/BE për koordinimin e masave mbrojtëse që kërkohen nga vendet e BE-së prej kompanive në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 54 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, në lidhje me formimin e shoqërive publike me përgjegjësi të kufizuar dhe mbajtjen dhe ndryshimin e kapitalit të tyre.

**Direktiva (BE) 2017/828** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 maj 2017 për ndryshimin e Direktivës 2007/36/KE në lidhje me inkurajimin e angazhimit afatgjatë të aksionarëve.
Direktiva 2007/36/KE përcakton kërkesat në lidhje me ushtrimin e të drejtave të caktuara të aksionareve që i bashkëngjiten aksioneve me të drejtë vote në lidhje me mbledhjet e përgjithshme të shoqërive që kanë selinë e tyre të regjistruar në një Shtet Anëtar dhe aksionet e të cilave pranohen për tregtim në një treg të rregulluar të vendosur ose që vepron brenda një shteti anëtar.

Kriza financiare ka zbuluar se aksionarët në shumë raste kanë mbështetur marrjen e tepruar të riskut afatshkurtër të menaxherëve. Për më tepër, ka prova të qarta se niveli aktual i 'monitorimit' të kompanive të investuara dhe angazhimi nga investitorët institucionalë dhe menaxherët e aseteve është shpesh i pamjaftueshëm dhe fokusohet shumë në kthimet afatshkurtra, gjë që mund të çojë në qeverisje dhe performancë jo optimale të korporatës.

**Direktiva 2019/1151** - Ndryshimi i **Direktivës (BE) 2017/1132** në lidhje me përdorimin e mjeteve dhe proceseve dixhitale në ligjin për kompanitë.
Kjo direktivë është publikuar më 11 korrik 2019, ka hyrë në fuqi më 31 korrik 2019 dhe duhet të ishte zbatuar në rregulloren kombëtare më së voni më 1 gusht 2021.
Direktiva (BE) 2019/1151 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 qershor 2019 që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 në lidhje me përdorimin e mjeteve dhe proceseve dixhitale në ligjin për kompanitë.
Direktiva (BE) 2019/1151 e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian e datës 20 qershor 2019 që ndryshon Direktivën (BE) 2017/1132 në lidhje me përdorimin e mjeteve dhe proceseve dixhitale në ligjin për kompanitë.

Ndërsa: Direktiva (BE) 2017/1132 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (3) përcakton ndër të tjera rregullat për zbulimin dhe ndërlidhjen e regjistrave qendrorë, tregtarë dhe të kompanive të Shteteve Anëtare.
Ndryshimi i Direktivës (BE) 2017/1132 në lidhje me përdorimin e mjeteve dhe proceseve digjitale në të drejtën e shoqërive tregtare.
Direktiva (BE) 2017/1132 përcakton ndër të tjera rregullat për zbulimin dhe ndërlidhjen e regjistrave qendrorë, komercialë dhe të kompanive të Shteteve Anëtare.
Përdorimi i mjeteve dhe proceseve dixhitale për të nisur më lehtë, më shpejt, me kohë dhe me kosto efektive aktivitetin ekonomik duke krijuar një kompani ose duke hapur një degë të asaj kompanie në një shtet tjetër anëtar dhe për të ofruar informacion të plotë dhe të qasshëm për kompanitë, është një nga parakushtet për funksionimin efektiv, modernizimin dhe riorganizimin administrativ të një tregu të brendshëm konkurrues dhe për sigurimin e konkurrencës dhe besueshmërisë së kompanive.

**Direktiva 2019/2121** - Ndryshimi i Direktivës (BE) 2017/1132 në lidhje me konvertimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare.
Direktiva (BE) 2017/1132 rregullon bashkimet ndërkufitare të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar. Rregullat për bashkimet ndërkufitare përfaqësojnë një moment historik të rëndësishëm në përmirësimin e funksionimit të tregut të brendshëm për kompanitë dhe firmat dhe ushtrimin e tyre të lirisë së themelimit. Megjithatë, vlerësimi i këtyre rregullave tregon se ato duhet të ndryshohen. Për më tepër, është e përshtatshme të parashikohen rregulla që rregullojnë konvertimet dhe ndarjet ndërkufitare, pasi Direktiva (BE) 2017/1132 parashikon vetëm rregulla për ndarjet e brendshme të shoqërive me përgjegjësi të kufizuara publike.

**Direktiva 2004/109/EC** – kërkesat e transparencës në lidhje me informacionin për emetuesit, letrat me vlerë të të cilëve janë të pranuara për tregtim në një treg të rregulluar.
Kjo direktivë synon të përmirësojë informacionin që u jepet investitorëve në lidhje me lëshuesit e letrave me vlerë të pranuar për tregtim në një treg të rregulluar, të vendosur ose që veprojnë në një vend të BE-së. Kërkon që vendet e BE-së të publikojnë informacione periodike financiare për

të ardhurat e tyre gjatë gjithë vitit financiar, përveç informacionit të vazhdueshëm në lidhje me posedimin e përqindjeve të konsiderueshme të të drejtave të votës.
Direktiva e transparencës u ndryshua në vitin 2013 me Direktivën 2013/50/BE. Ky amendament synon të:

- zvogëlojë barrën administrative që rëndon mbi emetuesit e vegjël dhe të mesëm, në mënyrë që të përmirësohet qasja e tyre në kapital;
- përmirësojë efikasitetin e sistemit të transparencës, veçanërisht në lidhje me publikimin e informacionit mbi pronësinë e korporatave.

Direktiva 2013/50/BE duhej të përfshihej në legjislacionin kombëtar të vendeve të BE-së deri më 26 nëntor 2015.

Kësisoj, në tabelën si më poshtë numërohen aktet ligjore dhe nënligjore relevante për çështjen e trajtuar në këtë Koncept Dokument, identifikohen institucionet që janë përgjegjëse për zbatim dhe kompetencat përkatëse të këtyre institucioneve.

*Nevoja për avancim të mëtejme të shërbimeve elektronike sa i përket regjistrimit, ndryshimeve, çregjistrimit, shuarjes së bizneseve*

Me ligjin aktual për shoqëri tregtare nuk parashihet mundësia e lëshimit të certifikatës së regjistrimit në mënyrë elektronike, ky ligj kërkon që në momentin e tërheqjes se certifikatës se regjistrimit të dorëzohet komplet dosja e aplikimit për regjistrimin e biznesit të mundësohet përfundimin i gjithë procedurës për regjistrim të biznesit në mënyrë elektronike në rastet kur aplikimi është bere në mënyrë elektronike duke përfshirë edhe pajisjen me certifikate të regjistrimit poashtu, kërkohet që të arkivohet dosja e regjistrimit në mënyrë fizike dhe elektronike.

*Efektet*

Problemet e lartshënuara dhe shkaqet përkatëse, në punën e organeve ekzekutive, aktivitetin e shoqërive tregtare dhe në përgjithësi në ambientin e të bërit biznes në Kosovë përcillen me efekte negative duke krijuar vështirësitë në regjistrimin të korporatave si rezultat i kufizimeve ligjore rreth kuotës gjinore të përcaktuar, largimi i investitorëve nga vendi, pamundësia në masën e duhur të ofrimit të shërbimeve elektronike (kapacitetet elektronike të ARBK-se janë funksionale për kryerjen e shërbimeve elektronike por në mungesë të të dispozitave ligjore nuk mund të realizohet këto shërbime elektronike).

*Figura 3: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit*

| **Emri i palës së interesuar** | **Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala** | **Efekti-et me të cilat është e lidhur pala** | **Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)** |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë | Mangësitë ligjore | Rrezikimi i ekonomisë së Kosovës | |
| Administrata Tatimore | Mospërputhja e te dhënave ndërinstitucionale ARBK-ATK | Barrë administrative për subjektet ekonomike dhe institucionet publike | Koordinim i pamjaftueshëm ndërinstitucional |

## KAPITULLI 2:

## OBJEKTIVAT

Qëllimi kryesor i politikës së propozuar e cila ka të bëjë me Shoqëritë Tregtare është të përmirësojë kornizën ligjore dhe të sigurojë një nivel të lartë të ofrimit të shërbimeve ndaj shoqërive tregtare si një parakusht për rritjen e një tregu më të fortë, më dinamik dhe konkurrues. Përmirësimi i kornizës ligjore synon arritjen e pajtueshmërisë më të madhe me standardet dhe praktikat e Bashkimit Evropian. Kjo është gjithashtu në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit e cila adreson faktorët që aktualisht janë duke kufizuar rritjen ekonomike dhe përmirësimin e standardit të jetesës në Kosovë. Kjo politikë kontribuon në përmbushjen e përparësive të reformave ekonomike dhe institucionale që rrjedhin nga MSA dhe dokumentet strategjike, përkatësisht: Agjenda e Reformës Evropiane dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA (2022-2024).

**Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës** si qëllim strategjik ka përcaktuar Përmirësimin e mjedisit të të bërit biznes. Për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe zhvillimit të konkurrueshmërisë, do të avancojmë kornizën ligjore për konkurrencën, shoqëritë tregtare dhe përmirësimin e regjistrave të bizneseve për të mundësuar një administrim efikas të tatimeve, menaxhim efektiv të pajtueshmërisë dhe ofrimin e statistikave të duhura.

**Programi për Zvogëlimin e Barrës Administrative-**Njëri nga parimet kryesore të administratës publike është ofrimi i shërbimeve publike administrative, përkatësisht përmirësimi e lehtësimi i marrjes së tyre dhe modernizimi në vazhdimësi, si për qytetaret e bizneset, ashtu edhe për vet administratën.
Më konkretishtë, në këtë dokument, në kuadër të masave që do të propozohen për zbatim, do të përfshihen aktivitetet që rrjedhin nga dokumentet strategjike që kanë të bëjnë me digjitalizimin e shërbimeve dhe aktivitetet që rrjedhin nga Plani i Veprimit për Interoperabilitet në lidhje me shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve dhe zbatimin e parimeve "vetëm një herë" dhe "personalizim" në përgjithësi.

**Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), PRE, ERA**
Gjithashtu, në Planin Strategjik dhe Operacional të Qeverisë si qëllim strategjik është përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe zhvillimi i konkurrueshmerise në sektorin privat, me objektiv specifik Përmirësimi i kornizës ligjore të shoqërive tregtare.

Më poshtë përcaktohet një prezantim i objektivave përkatës të Qeverisë në fushën e shoqërive tregtare.

*Tabela 4: Objektivat relevante të Qeverisë*

| **Qëllimi i politikës** | **Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (Origjina)** |
|---|---|
| Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe zhvillimi i konkurrueshmerise në sektorin privat | Programi i Qeverisë 2020-2025, SKZH,MSA, PKZMSA, ARE..... |
| Objektivat specifikë- Përmirësimi i kornizës ligjore të shoqërive tregtar | Programi i Qeverisë, SPO |
| Përafrimi i mëtejshëm me acquis e BE-së | MSA, PKZMSA, ARE ..... |
| Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe administrative të organeve të zbatimit dhe forcimi i sistemit të koordinimit ndërinstitucional | Programi i Qeverisë, MSA, PKZMSA, ARE |
| Funksionalizimi i shërbimeve digjitale dhe ndërveprim i sistemeve elektronike | PZBA |
| Rritja e ndërgjegjësimit përmes fushatave vetëdijesuese | PKZMSA |

# KAPITULLI 3:

## OPSIONET

Koncept Dokumenti trajton tre opsione kryesore lidhur me rregullimin e çështjes së shoqërive tregtare. Opsioni *pa asnjë ndryshim* i cili parasheh ruajtjen e *status quo*; opsioni për *përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit të kornizës ligjore* i cili nuk parasheh ndryshime legjislative mirëpo fokusohet në zbatimin e ligjeve të cilat veçse ekzistojnë; dhe së fundi opsioni me *ndryshime legjislative* i cili parasheh plotësim ndryshimin e legjislacionit për shoqëritë tregtare.

Bazuar ne analizen e mesiperme, problematikat qe kane te bëjnë me mungesë, plotësime dhe mosharmonizim të dispozitave ligjore, si; kërkesa ligjore për 50% të grave në bord të drejtorëve të korporatave; mungesa e kapitalit themeltare për SH.P.K; pamundësia e plotësimit të statutit me ndryshime; mungesa e rregullimit ligjor që ARBK të mbaj një listë të bizneseve jo aktive dhe publikimi i raporteve financiare të KKRF në ueb faqen e ARBK-së., rekomandohet te rregullohen përmes ndryshimit dhe plotësimit te legjislacionit aktual.

*<u>Figura 6. Analizë krahasuese e shteteve të cilat kanë miratuar legjislacion për Shoqerite Tregtare</u>*

| SHTETI | LEGJISLACIONI | FUSHËVEPRIMI I LIGJIT | ADMINISTRIMI I LIGJIT PER SHOQERIT TREGTARE |
|---|---|---|---|
| SHQIPËRIA | LIGJ Nr.9901, datë 14.4.2008 PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE<br><br>LIGJ Nr. 129/2014 PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9901, DATË 14.4.2008, "PËR | Ky ligj rregullon statusin e tregtarit, themelimin dhe administrimin e shoqërive tregtare, të drejtat dhe detyrimet e themeluesve, të ortakëve dhe aksionarëve, riorganizimin dhe likuidimin e shoqërive tregtare. Shoqëritë tregtare janë shoqëritë kolektive, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare. 2. Tregtarët dhe shoqëritë tregtare regjistrohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. | Ligji për shoqëritë tregtare administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit.<br><br>Qendra Kombëtare e Biznesit është përgjegjëse:<br><br>a) të regjistrojë, të administrojë, të përpunojë dhe të ruajë në regjistër të dhënat e deklaruara nga subjektet raportuese;<br><br>b) të mundësojë disponueshmërinë e të dhënave të Regjistrit, në përputhje me nenin 7 të këtij ligji;<br><br>c) të lëshojë ekstrakte për të dhënat e regjistruara në regjistër;<br><br>ç) të ndërmarrë veprime të tjera në përputhje me këtë ligj. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | TREGTARË T DHE SHOQËRIT Ë TREGTARE ", TË NDRYSHU AR | | d) Me rastin e themelimit te SHPK dhe SHA nuk kërkohet kuota gjinor tek bordi i drejtoreve.<br>Poashtu me rastin e themelimit te SHPK kërkohet kapitali themeltar prej 100 lek (80 cent). |
| KROACIA | Ligji për Shoqëritë Tregtare NN NN 111/93, 34/99, 121/99, 52/00, 118/03, 107/07, 146/08, 137/09, 125/11, 152/11, 111/12, 68/13, 110/15, 40/19, 34/22. | Ky ligj rregullon themelimin, organizimin, përfundimin dhe ndryshimin e statusit të shoqërive tregtare dhe filialet.<br>Me kete ligj rregullohet koncepti i tregtarit dhe Shoqerive tregtare:<br>(1) Tregtar është personi i cili është i pavarur në mënyrë të përhershme, përveç nëse me këtë ligj parashihet ndryshe<br>kryen veprimtari ekonomike me qëllim të përfitimit nga prodhimi, tregtia e mallrave ose ofrimi i shërbimeve në treg.<br>(2) Personat që merren me profesione të lira konsiderohen se janë të rregulluar me rregullore të veçanta tregtarëve në kuptim të këtij ligji vetëm nëse është përcaktuar në ato rregullore.<br>(3) Shoqëritë janë shoqëria publike, shoqëria komandite, shoqëria aksionare, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria e interesit ekonomik (në tekstin e mëtejmë: shoqëritë).<br>(4) Shoqëria publike, shoqëria komandite dhe shoqëria e interesit ekonomik janë<br>shoqëritë e personave, dhe shoqëria aksionare dhe shoqëria me përgjegjësi të kufizuar janë shoqëri kapitale.<br>(5) Shoqëria mund të themelohet për kryerjen e veprimtarisë ekonomike ose të ndonjë veprimtarie tjetër.<br>(6) Shoqëria është tregtar, pavarësisht nëse ushtron afarizëm apo ndonjë punë tjetër<br>aktivitetet. | Një shoqëri tregtare fiton statusin e personit juridik duke e regjistruar atë në regjistrin gjyqësor. Kompania humbet statusin e personit juridik duke e fshirë atë shoqëri nga regjistri gjyqësor.<br><br>Një shoqëri tregtare mund të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime në transaksionet juridike, mund të jetë pronare e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe mund të padisë dhe të paditet përpara një shteti ose një gjykate të zgjedhur<br>dhe të marrë pjesë në procedura të tjera.<br><br>Me rastin e themelimit te SHPK dhe SHA nuk kërkohet kuota gjinor tek bordi i drejtoreve.<br>Po ashtu me rastin e themelimit te SHPK kërkohet kapitali themeltar prej 20,000 kuna (2646 euro). |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | (7) Fermerët individualë nuk janë tregtarë sipas kuptimit të këtij ligji.<br><br>Ky ligj transpozon në sistemin ligjor kroat:<br>- Direktiva 2007/36 / KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 1 korrik 2007 mbi zbatimin të disa të drejtave të aksionerëve të listuar (OJ L 184, 14.7.2007) i ndryshuar për herë të fundit nga Direktiva (BE) 2017/828 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 17 maj 2017 që ndryshon Direktivën 2007/36 / KE me synimin për të inkurajuar pjesëmarrjen afatgjatë (Tekst me rëndësi për ZEE) (OJ L 132, 20.5.2017),<br>- Direktiva 2009/102 / KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 shtator 2009 në fushën e të drejtat e shoqërisë në shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar me një anëtar të vetëm (versioni i kodifikuar) (Tekst me rëndësi për ZEE) (OJ L 258, 1.10.2009),<br>- Direktiva e Këshillit 2013/24 / BE e 13 majit 2013 duke përshtatur direktiva të caktuara në fushën e së drejtës për shoqëritë tregtare për shkak të aderimit të Republikës së Kroacisë (OJ L 158, 10.6.2013),<br>- Direktiva (BE) 2017/1132 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 qershor 2017 për disa aspekte të së drejtës së shoqërive tregtare (tekst i kodifikuar) (Tekst me rëndësi për ZEE) (OJ L 169, 30.6.2017). | |

## *Kapitulli 3.1: Opsioni asnjë ndryshim*

Opsioni asnjë ndryshim nënkupton që nuk do të merren kurrfarë masa as zbatuese dhe as legjislative për të adresuar problemin kryesor, të shpjeguar më lartë. Me opsionin pa asnjë ndryshim do të vazhdonte të ekzistoj problemi kryesor lidhur me mungesën e zbatueshmerisë se

legjislacionit adekuat për shoqëritë tregtare. Rrjedhimisht, efektet të cilat mund t'i prodhojë prania e këtij problemi do të vazhdojnë të mbesin rrezik për mos zbatueshmëri të ligjit aktual.

Siç është elaboruar më lartë në kuadër të kapitullit për problemin kryesor, ndonëse Kosova ka ligjin për shoqëri tregtare mirëpo, ka hasur në mozbatueshmeri të disa prej dispozitave

## Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

Një opsion tjetër i shqyrtuar nga grupi punues është opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit. Pavarësisht diskutimeve dhe analizave të grupit punues, duke marr parasysh parimin e ligjshmërisë, ky opsion është konstatuar se nuk është i përshtatshëm ngase krijimi i një ligji te ri është i panevojshme.

## Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë

Opsioni i tretë do të shqyrtojë mundësinë e ndryshimit të kornizës ligjore të Kosovës me qëllim të plotësim ndryshimit të dispozitave për shoqëritë tregtare të ligjit aktual.
Hulumtimi i realizuar për qëllime të këtij Koncept Dokumenti ka identifikuar modele të cilat aplikohen nga shtetet në regjion dhe më gjerë për regjistrimin e shoqërive tregtare të cilat janë të përafërta me ligjin aktual, përjashtimit të disa dispozita të cilat kanë hasur vështirësi gjatë regjistrimit të bizneseve.

Propozimi parasheh plotësimin ndryshimin e ligjit aktual për shoqëritë tregtare, e që në fokus do te jenë dispozitat si në vijim:

1.1. Te ndryshohet neni 41 paragrafi 3.4 dhe te harmonizohet me neni 164 paragrafi 2.
Gjithashtu neni 33 dhe 34 i ligjit aktual dhe te harmonizohet me neni 164 paragrafi 2.
1.2. Të ndryshohen dispozitat ligjore të Ligjit për shoqëri tregtare për Bordin dhe Drejtoret Menaxhues të Shoqërisë Aksionare për numrin e anëtareve duke e lënë si alternative përbërjen e kuotës gjinore por jo si obligative
1.3. Të shtohen dispozita ligjore për përfshirje edhe të shumës së kapitalit themeltar me rastin e themelimit të Sh.P.K.
1.4. Te lejohet qe ndryshimet statusore te behen me aneks statut.
Në rast të dorëheqjes nga Personi i Autorizuar nga kjo pozitë, Personi i Autorizuar mund të kërkojë nga ARBK për të bërë ndryshimet përkatëse në Regjister, nëse dorëzon në ARBK dokumentin e dorëheqjes dhe dëshminë që ka njoftuar organin kompetent të Shoqërisë Tregtare për dorëheqjen.
Drejtori menaxhues mund të caktohet, largohet ose zëvendësohet vetëm në bazë të votës së Aksionarëve ose të Bordit të Drejtorëve.
1.5. Të shtohen dispozita ligjore qe ARBK ti mundësohet krijimit i regjistrit pasiv te shoqerive tregtare
1.6. ARBK te publikon raportet financiarAe te shoqërive tregtare te njetat sic i publikon KKRF.
1.7. Te harmonizohen dispozitat ligjore te Ligjit Nr. 06/1-016 për Shoqëritë Tregtare me Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore lidhur me regjistrimin e përfaqësuesit fiskal.

1.8. Këto dispozita të ndryshohen ashtu qe t'i lejohet që në raste specifike me dëshmi të vdekjes dhe të trashëgimisë, t'i bartet pronësia (historiku) i biznesit tek trashëgimtari.

Si përfundim, propozimi i rekomanduar për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit aktual për shoqëri tregtare konsiderohet se do te jete shume me i favorshëm për çështjet që rregullon regjistrimin e shoqërive tregtare dhe në përgjithësi veprimtarinë e tyre biznesore.

## KAPITULLI 4:

## IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I NDIKIMEVE TË ARDHSHME

Sa i përket identifikimit dhe vlerësimit te ndikimeve te ardhshme vlen te ceket si çështje kryesore largimi i kuotës gjinore 50% te grave në borde i cili ndikon pozitivisht te NVM dhe korporatat si dhe me rastin e themelimit te SHPK-ve të përcaktohet kapitali themeltar.

Në tabelën e mëposhtme listohen ndikimet më të rëndësishme të identifikuara të dy opsioneve të para.

*Figura 7: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit*

| **Kategoritë e ndikimeve** | **Ndikimet përkatëse të identifikuara** | |
|---|---|---|
| | **Opsioni 1** | **Opsioni 2** |
| Ndikimet ekonomike | | |
| Ndikimet shoqërore | | |
| Ndikimet mjedisore | | |
| Ndikimet në të drejtat themelore | | |
| Ndikimi gjinor | | Largimi i kuotës gjinore 50% te grave ne borde ndikon pozitivisht te NVM-korporatat. |
| Ndikimet e barazisë sociale | | |
| Ndikimet tek të rinjtë | | |
| Ndikimet në ngarkesën administrative | | |
| Ndikimi i NMV-ve | | Largimi i kuotës gjinore 50% te grave ne borde ndikon pozitivisht te NVM-korporatat.2.Me rastin e themelimit te SHPK-ve te përcaktohet kapitali themeltar. |

Ndikimet më të rëndësishme në kuadër të opsionit të tretë do të trajtohen veçmas në kuadër të tabelës vijuese. Ky elaborim do vlejë njëkohësisht për të dy modelet në kuadër të opsionit për ndryshime ligjore.

| **Kategoritë e ndikimeve** | **Ndikimet përkatëse të identifikuara** - opsioni 3 |
|---|---|
| Ndikimet ekonomike | x |
| Ndikimet shoqërore | |
| Ndikimet mjedisore | |
| Ndikimet në të drejtat themelore | X |
| Ndikimi gjinor | Largimi i kuotës gjinore 50% te grave ne borde ndikon pozitivisht te NVM-korporatat. |
| Ndikimet e barazisë sociale | x |
| Ndikimet tek të rinjtë | x |
| Ndikimet në ngarkesën administrative | x |
| Ndikimi i NMV-ve | Largimi i kuotës gjinore 50% te grave ne borde ndikon pozitivisht te NVM-korporatat.2.Me rastin e themelimit te SHPK-ve te përcaktohet kapitali themeltar. |

**Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave**

Me rastin e mbledhjes se te dhënave, ARBK nuk ka hasur në vështirësi ne këtë fushe.

# KAPITULLI 5:

# KOMUNIKIMI DHE KONSULTIMI

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë ka konsultuar faktorë relevant vendor e ndërkombëtar si pjesë e procesit të identifikimit dhe formulimit të politikave mbi shoqëritë tregtare.

Palët kryesore të konsultuara përfshijnë organizata GIZ, ATK, Donaga, ZKM, Banka Boterore etj.

Ne muajt ne vijim planifikohen takime tjera te radhës për Grupin Punues, takimin me publikun me te gjitha palët e interesit, konsultimin paraprak dhe konsultimin me publikun ne platformën online.

***Figura 4: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument***

| Procesi i konsultimit synon: | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Qëllimi kryesor | Grupi i synuar | Aktiviteti | Komunikimi/njoftimi | Afati indikativ | Buxheti i nevojshëm | Personi përgjegjës |
| Takimi i hapur për të gjithë palët e interesuara | Të gjitha palët e interesuara | Takim publik | Takimi publik është mbajtur me 23.09.2021 ne sallën P 38 ne Qeveri | | | |
| Konsultimi publik me shkrim | Të gjitha palët e interesuara | Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |

## KAPITULLI I 6:

## KRAHASIMI I OPSIONEVE

Siç është cekur më lartë, grupi punues ka trajtuar gjithsej tri opsione për adresimin e problemit: Opsioni 1 (*status-quo*), Opsioni 2 (ndryshimi i mënyrës së zbatimit dhe ekzekutimit) dhe Opsioni 3 (hartimi i Ligjit të ri).

Opsioni 2 synon adresimin e problemit kryesor përmes ndërmarrjes së aktiviteteve të caktuara që ndryshojnë mënyrën e deritashme të zbatimit dhe ekzekutimit të politikave dhe ligjeve në fushën e shoqërive tregtare. Ky opsion me këtë rast nuk mund të zbatohet sepse tek Ligji aktual janë evidentuar boshllëqe si ne fushën e zbatimit, njashtu karshi politikave te BE-s te cilat konsiderohet se duhet implementuar.

Opsioni 3 është opsioni që parasheh ndryshime ligjore, gjegjësisht plotësim ndryshimin e Ligjit për shoqëritë tregtare dhe ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara për zbatimin e tij.

*Figura 5: Plani i zbatimit për Opsionin 3*

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qëllimi i politikës | Përmirësimi i kornizës ligjore në fushën e shoqërive tregtare | | | | | | | | Shifra e pritshme e kostos |
| Objektivi strategjik | - Përmirësimi i mjedisit të biznesit dhe zhvillimi i konkurrueshmerise në sektorin privat<br>- Përafrimi i mëtejshëm me acquis e BE-së<br>- Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe administrative të organeve të zbatimit dhe forcimi i sistemit të koordinimit ndërinstitucional<br>- Funksionalizimi i shërbimeve digjitale dhe ndërveprim i sistemeve elektronike<br>- Rritja e ndërgjegjësimit përmes fushatave vetëdijesuese | | | | | | | | |
| | Produkti, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës | | | | | | | | |
| Përmirësimi i kornizës ligjore të shoqërive tregtar | 1.1 | Ligji per Shoqerite Tregtare i miratuar | | | | | | | |
| | | | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 | Institucioni /departamenti përgjegjës | |
| | | Aktiviteti 1.1.1 | Themelimi i grupit punues | | | | | ARBK | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Aktiviteti 1.1.2 | Procesi i konsultimit | | | | | ARBK | |
| | | Aktiviteti 1.1.3 | Miratimi ne qeveri | | | | | | |
| | Produkti 1.2 | Aktet nënligjore | | | | | | | |
| | | | Viti 1 | Viti 2 | Viti 3 | Viti 4 | Viti 5 | Institucioni /departamenti përgjegjës | |
| | | Aktiviteti 1.2.1 | | Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore | | | | ARBK | |
| Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe administrative të organeve të zbatimit dhe forcimi i sistemit të koordinimit ndërinstitucional | Produkti 2.1 | 2.1.2 | | Dy trajnime te organizuara | | | | | |
| | Produkti 2.2 | 1.2.2 | | Organizimi i takimeve te rregullta me institucionet relevante | | | | | |
| Funksionalizimi i shërbimeve digjitale dhe ndërveprim i sistemeve | Produkti 3.1 | 3.1.1 | Krijimi dhe funksionalizimi i sistemeve për shërbime që nder veprojnë | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| elektronik e | | | | | | | | | |

# KAPITULLI 7:

# KONKLUZIONET DHE HAPAT E ARDHSHËM

Opsioni i rekomanduar nga grupi punues është opsioni 3 plotësim ndryshimi i Ligjit për shoqëritë tregtare, duke hartuar edhe aktet nënligjore për zbatim sa më të mire të plotësim ndryshim të Ligjit për shoqeritë tregtare.

## 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Sipas të gjitha analizave të bëra nga ky Koncept Dokument, siç është cekur edhe më lartë, i vetmi opsion që garanton për adresimin e problemeve të identifikuara në fushen e Shoqerive Tregtare është adresimi me ndryshime ligjore, meqë shkaku kryesor i problemeve të identifikuara janë dispozitat ligjore që krijojnë probleme per Shoqerite tregtare ne zbatim te Ligjit per Shoqerite Tregtare nr.06/L-016.

Plani për zbatimin e këtij Koncept Dokumenti, me kusht që aprovohet me opsionin e rekomanduar, është si në vijim:

| Veprimi | Afati Kohor |
|---|---|
| 1. Miratimi i Koncept Dokumentit per Shoqerite Tregtare | K2 2022 |
| 2. Hartimi i Plotësim ndryshimet te Ligjit per Shoqerite Tregtare nr.06/L-016. | K2 2023 |
| 3. Aprovimi i Plotësim Ndryshimit te Ligjit per Shoqerite Tregtare nr.06/L-016 në Qeverinë e Republikës së Kosovës. | K2 2023 |
| 4. Miratimi i Plotësim Ndryshimit te Ligjit per Shoqerite Tregtare nr.06/L-016 në Kuvendin e Republikës së Kosovës | K4 2023 |
| 5. Zbatimi i Plotësim Ndryshimit te Ligjit per Shoqerite Tregtare nr.06/L-016 dhe hartimi i legjislacionit sekondar | K4 2024 |

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

| **Kategoria e ndikimeve ekonomike** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Po | Jo | I lartë/i ulët | I lartë/i ulët | |
| Vendet e punës[1] | A do të rritet numri aktual i vendeve të punës? | x | | I mesëm | | |
| | A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës? | | x | | | |
| | A do të ndikojë në nivelin e pagesës? | | x | | | |
| | A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës? | | x | | | |
| Bërja e biznesit | A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes? | | x | | | |
| | A do të largohen nga tregu produkte të caktuara? | | x | | | |
| | A do të lejohen në treg produkte të caktuara? | | x | | | |
| | A do të detyrohen bizneset të mbyllen? | | x | | | |
| | A do të krijohen biznese të reja? | x | | | | |
| Ngarkesa administrative | A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja? | | x | | | |
| | A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset? | | x | | | |
| Tregtia | A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit? | | x | | | |

[1] Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit? | | X | | | |
| Transporti | A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave? | | X | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra? | | X | | | |
| Investimet | A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja? | | x | | | |
| | A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet? | | X | | | |
| | A do të rriten investimet nga diaspora? | x | | | | |
| | A do të zvogëlohen investimet nga diaspora? | | X | | | |
| | A do të rriten investimet e huaja direkte? | X | | | | |
| | A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte? | | X | | | |
| Konkurueshmëria | A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike? | | x | | | |
| | A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike? | | x | | | |
| | A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi? | | x | | | |
| | A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen? | | x | | | |
| Ndikimi në NVM | A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM? | x | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Çmimet dhe konkurrenca | A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët? | | x | | | |
| | A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët? | | x | | | |
| | A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese? | | x | | | |
| | A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese? | | x | | | |
| Ndikimet ekonomike rajonale | A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit? | | x | | | |
| | A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar? | | x | | | |
| Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik | A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike? | | x | | | |
| | A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit? | | x | | | |

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

| **Kategoria e ndikimeve shoqërore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Vendet e punës [2] | A do të rritet numri aktual i vendeve të punës? | | x | | | |
| | A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës? | | x | | | |
| | A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit? | | x | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës? | | x | | | |
| Ndikimet shoqërore rajonale | A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta? | | x | | | |
| Kushtet e punës | A ndikohen të drejtat e punëtorëve? | | x | | | |
| | A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet | | x | | | |

[2] Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | punonjësve dhe punëdhënësve? | | | | | |
| Përfshirja sociale | A do të ketë ndikim mbi varfërinë? | | x | | | |
| | A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale? | | x | | | |
| | A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale? | | x | | | |
| Arsimi | A do të ketë ndikim në arsimin fillor? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në arsimin e lartë? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në aftësimin profesional? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen? | | x | | | |
| Kultura | A ndikon opsioni në diversitetin kulturor? | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore? | | x | | | |
| Qeverisja | A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik? | | x | | | |
| | A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë? | x | | | | |
| | A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara? | x | | | | |
| | A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike? | | x | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile? | | x | | | |
| Shëndeti dhe siguria publike[3] | A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit? | | x | | | |
| | A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për | | x | | | |

[3] Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | shkak të substancave të dëmshme? | | | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës? | | x | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë? | | x | | | |
| | A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit? | | x | | | |
| | A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)? | | x | | | |
| Krimi dhe siguria | A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët? | | x | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi? | | x | | | |
| | A ndikon në nivelet e korrupsionit? | | x | | | |
| | A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit? | | x | | | |
| | A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit? | | x | | | |

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

| **Kategoria e ndikimeve mjedisore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm | A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)? | | x | | | |
| | A do të ndikohet konsumi i karburanteve? | | x | | | |
| | A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë? | | x | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit? | | x | | | |
| | A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara? | | x | | | |
| Cilësia e ajrit | A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit? | | x | | | |
| Cilësia e ujit | A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm? | | x | | | |
| Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës | A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në erozionin e tokës? | | x | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)? | | x | | | |
| | A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)? | | x | | | |
| | A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)? | | x | | | |
| Mbeturinat dhe riciklimi | A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara? | | x | | | |
| | A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat? | | x | | | |
| | A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave? | | x | | | |
| Përdorimi i burimeve | A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)? | | x | | | |
| Shkalla e rreziqeve mjedisore | A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet? | | x | | | |
| | A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore? | | x | | | |
| | A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore? | | x | | | |
| Biodiversiteti, flora dhe fauna | A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë? | | x | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës? | | x | | | |
| | A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar? | | x | | | |
| Mirëqenia e kafshëve | A do të ndikohet trajtimi i kafshëve? | | x | | | |
| | A do të ndikohet shëndeti i kafshëve? | | x | | | |
| | A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve? | | x | | | |

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

| **Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore** | **Ndikimi kryesor** | **A pritet të ndodhë ky ndikim?** | | **Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur** | **Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit** | **Niveli i preferuar i analizës** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Po** | **Jo** | **I lartë/i ulët** | **I lartë/i ulët** | |
| Dinjiteti | A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi? | | x | | | |
| Liria | A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit? | | x | | | |
| Të dhënat personale | A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale? | | x | | | |
| | A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara? | | x | | | |
| | A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale? | | x | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Azili | A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil? | | x | | | |
| Të drejtat pronësore | A do të ndikohen të drejtat e pronësisë? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes? | | x | | | |
| Trajtimi i barabartë [4] | A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit? | | x | | | |
| | A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)? | | x | | | |
| | A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara? | | x | | | |
| Të drejtat e fëmijëve | A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve? | | x | | | |
| Administrimi i mirë | A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuara? | | x | | | |
| | A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)? | | x | | | |
| | Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit? | | x | | | |
| | A ndikohet qasja në drejtësi? | | x | | | |

[4] Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*